

DERI TE:

KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR I FAKULTETIT JURIDIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Në pajtim me nenin 173 të Ligjit të Arsimit të Lartë (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 82/2018 dhe Gazet Zyrtare e RMV-së, nr. 178/2021), me Vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës, me nr. 13-332/2 të datës 29.06.2026 në bazë të Konkursit të shpallur më 19.06.2026 në gazetatat ditore „Koha“ dhe „Sloboden Peçat“ si dhe në web faqen e Universitetit të Tetovës të datës 10.06.2026 www.unite.edu.mk, për zgjedhjen e një asistenti në lëmin **Shkenca kriminale** (5.09.02.01, nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), u zgjodh Komisioni recensues në këtë përbërje:

1. **Prof. Dr. Qebir Avziu (kryetar)**
2. **Doc. Dr. Shaban Jakupi (anëtar)**
3. **Prof. Dr. Safet Emruli (anëtar)**

Komisioni recensues pas shqyrtimit të dokumentacionit sipas konkursit, dorëzon këtë:

R E F E R A T

**PËR ZGJEDHJE TË NJË ASISTENTI NË LËMIN SHKENCA
KRIMINALISTIKE (5.09.02.01) NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE
LËMENJVE SHKENCORË-HULUMTUES SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR
TË FRASKATIT) NË FAKULTETIN JURIDIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS**

- I. Në konkursin e shpallur në gazetatat ditore „Koha“ dhe „Sloboden Peçat“ të datës 19.06.2026 si dhe në ueb-faqen e Universitetit www.unite.edu.mk, për zgjedhjen e një asistenti në lëmin **Shkenca kriminale** (5.09.02.01, nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në Programin studimor Kriministikë, është paraqitur vetëm kandidati Mr.Sc. Ardi Ameti. Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar si dhe të dhënave të tjera të kandidatit, Komisioni recensues ofron vlerësimet e mëposhtme:

1. Të dhëna biografike dhe arsimimi

Ardi Ameti është lindur më 30.11.1998 në Tetovë. Ka kryer arsimin fillor në shkollën fillore “Naim Frashëri” (2005-2013) dhe arsimin e mesëm në shkollën e mesme “Nikolla Shtejn”

(2013-2017) në Tetovë. Studimet i ka kryer në periudhën 2017-2020 në Fakultetin Juridik – Programi Kriminalistikë dhe ka fituar kualifikimin Baçelor i Kriminalistikës. Në fakultetin Juridik – Programi e drejta penale ka magjistruar në vitin 2023 dhe ka fituar kualifikimin Magjistër i së drejtës penale. Në vitin 2025 është regjistruar në studimet e doktoraturës në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” - Shkup.

2. Veprimtaria kërkimore-shkencore

- Pjesëmarrës në Konferencën e dhjetë shkencore të Fakultetit Juridik, me punimin me temë “Legal application of the detention measure as a guarantee of human rights and legal security: legal analysis of the implementation of the measure of detention in accordance with article 5 of the European Convention on Human Rights”, në bashkëpunim me Fatbardha Ismaili, Universiteti i Tetovës, 12-13.11. 2025.

3. Veprimtaria profesionale-aplikative

- I angazhuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme (nga viti 2026 dhe vazhdon aktualisht).
- Pjesëmarrës në aktivitetet për promovimin e Fakultetit Juridik.

II. Përfundim

Ky referat përmbillet me recensionin e një kandidati të paraqitur në konkursin publik. Sipas përshkrimit kandidati Ardi Ameti sipas dokumentacionit të dorëzuar, i plotëson kushtet e kërkuara ligjore sipas nenit 173 të Ligjit të Arsimit të Lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/2018 dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 178/2021), i posedon të gjitha dokumentet e kërkuara:

- Diplomë për kryerjen e ciklit të parë të studimeve në programin studimor Kriminalistikë në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës me notë mesatare 8.80
- Diplomë për kryerjen e studimeve të magjistraturës në programin studimor E drejta penale në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës me notë mesatare 9.36
- Vërtetim se ndjek studimet e doktoraturës në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” - Shkup.
- Listë të punimeve shkencore nga pjesëmarrja në konferenca shkencore.
- Biografi e shkurtër.
- Punimi i magjistraturës.
- Vërtetimi për njohjen e një gjuhe të huaj

- Certifikatë nga libri amë i të lindurve.
- Certifikatë të shtetësisë.

III. Propozimi i komisionit recenzues

Në bazë të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit dhe kushteve të kërkuara për zgjedhjen e një **asistenti** në lëmin **Shkenca kriminalistike** (5.09.02.01, nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) dhe nenit 173 të Ligjit të Arsimit të Lartë (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 82/2018 dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 178/2021), Komisioni recenzues i propozon Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit Juridik:

- Kandidati **Mr.Sc. Ardi Ameti** të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore asistent në lëmin **Shkenca kriminalistike** (5.09.02.01, nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

Tetovë, 30.06.2026

Komisioni recensues:

Prof. Dr. Qebir Avziu (kryetar)

Doc. Dr. Shaban Jakupi (anëtar)

Prof. Dr. Safet Emruli (anëtar)

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË- SHKENCORË, SHKENCORË MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: ARDI AMETI

Institucioni: Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës

Fusha shkencore: Shkenca kriminalistike (5.09.02.01, nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN BASHKËPUNËTOR - ASISTENT

Nr.	KUSHTET E PËRGJITHHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Ka kryer studimet në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve akademike dhe ka fituar së paku 300 ECTS kredi	PO
2	Titulli i fituar - Magjistër i së drejtës penale Emri i fushës shkencore – E drejta penale	PO
3	Suksesi mesatar i arritur prej së paku 8,00 (tetë) në ciklin e parë dhe të dytë në studimet akademike, veçmas Suksesi mesatar në ciklin e parë – 8.80 Suksesi mesatar në ciklin e dytë – 9.36	PO
4	Ka njohuri nga së paku një gjuhë e huaj A) 1. Gjuhë e huaj – Angleze 2. Emri i dokumentit - Certifikatë 3. Dhënësi i dokumentit – Neting school 4. Data e dhënies së dokumentit - 08.06.2026	PO

